



NJOFTIM PËR KONTRATË

Shërbim

Procedurë e hapur

Kontratë Kornizë

*Në përputhje me Nenin 6 të Rregullave të Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës
(Shtator 2021)*

Data: 13.03.2023 Nr. i Prokurimit: BQK 22 013 221

I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Garibaldi 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni i Prokurimit	E-mail: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/451.	Fax: 038 243 763

II LËNDA E KONTRATËS II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: Shërbimet e pastrimit të objekteve të BQK-së
Lloji i prokurimit: Shërbim
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë (nëse aplikohen): Kontrate kornize 1 vjecare me mundësi vazhdimi
Variantet pranohen: n/a
Vlera e parashikuar e kontratës: 18,000.00
Ndarja në Pjesë: JO

III INFORMACIONE PËR FURNIZIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është që të përzgjidhet kontraktuesi që të ofroj shërbimet e pastrimit për nevojat e BQK-së, sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do tu shpërndalet në bazë të një kërkesë

IV KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESEMARRJE

Të gjitha kompanitë e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me aplikacionet e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik	<p><u>Kërkesa 1:</u> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.</p> <p><u>Evidenca 1:</u> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në Aneksin 3 të dosjes së tenderit.</p>
	<p><u>Kërkesa 2:</u> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Evidenca 2:</u> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>
	<p><u>Kërkesa 3:</u> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><u>Evidenca 3:</u> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre.</p>
Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale	<p><u>Kërkesa 4:</u> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><u>Evidenca 4:</u> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><u>Kërkesa 5:</u> Ofertuesi duhet të jetë i akredituar nga institucioni i pavarur sipas ISO standardeve, ISO 18001 për Certifikimin e sigurisë dhe shëndetit në punë</p> <p><u>Evidenca 5:</u> Kopje e certifikatës ISO 18001.</p>

	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre.
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Nuk aplikohen
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	<p><u>Kërkesa 6:</u> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy kontrata te natyrës se njëjtte (Pastrim të brendshëm të objekteve) gjate 3 (tri) viteve të fundit (2016,2017 dhe 2018)</p> <p><u>Evidenca 6:</u> Ofertuesi duhet te ofroj si dëshmi certifikatat përkatëse ose referencat qe evidentojnë realizimin e shërbimit të tillë duke bashkangjitur kopjet e kontratave përkatëse.</p> <p><u>Kërkesa 7:</u> Deklaratë se obligoheni t'i angazhoni 7 punëtor, pagesat e punëtorëve do të bëhen sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.</p> <p><u>Evidenca 7:</u> Deklaratë origjinale</p> <p><u>Kërkesa 8 :</u> Një deklaratë të veglave dhe pajisjeve teknike në dispozicion të ofertuesit që ofron shërbimet si</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Minimum një makinë (me akumulator ose elektrike) e cila bën larjen dhe terjen e sipërfaqeve. b) Minimum një vinç për pastrimin e xhamave të jashtëm. c) Minimum një thithëse elektrike. <p><u>Evidenca 8:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> a) Të dëshmohet me faturën e blerjes së makinës për larjen dhe terjen e sipërfaqeve. b) Të dëshmohet me librezë te regjistrimit të makinës vinç që është në emër të ofertuesit, gjithashtu në rast të ndonjë marrëveshje për shfrytëzimin e vinçit me qera, të dëshmohet përmes kontratës. c)Të dëshmohet me faturën e blerjes së thithëses elektrike. <p><u>Kërkesa 9:</u> Dorëzimi i katalogut për materialet e nevojshme për pastrim të zyrave dhe nyjave sanitare.</p> <p><u>Evidenca 9:</u> Ofertuesi duhet të dorëzojë katalogun me produktet e ofruara për piken 5 te specifikave teknike.</p>

	<p>Kërkesa 10: Një deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur për specifikacionet teknike për shërbimet e ofruara të cilat garantohej që përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.</p> <p>Evidenca 10 : Një deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur për specifikacionet teknike për shërbimet e ofruara të cilat garantohej që përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.</p>
III.1.3) Inspektimi i kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale	Banka Qendrore mund të dëshirojë, me shpenzimet e tij, të kryej një inspektim të operatorëve ekonomik tenderues për qëllime të verifikimit të kapacitetet disponuese vërtetimin e cilësisë, mjetet për transport dhe çdo informatë tjetër që janë të nevojshme që mund të dëshmojë që ofertuesi mund të realizoj kontratën

V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: E hapur

VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: Tenderi i përshtatshëm me çmimin më të lirë.

VII INFORMATA ADMINISTRATIVE

Kushtet për marrjen e e dosjes se tenderit : afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit 17.03.2023, ora 14:00 në e-mail adresën prokurimi@bqk-kos.org
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 17.03.2023, ora 14:00
Dokumentet me pagesë: Jo
Siguria e tenderit: 1,000.00 € (dymbëdhjetë mijë e pesëqind euro) për periudhë valide prej 90 dite.
Sigurimi i kontratës: n/a
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e hapjes
Afati i fundit i dorëzimit të ofertave :21.03.2023, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.
Takimi për hapjen e ofertave: 21.03.2023, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr.“Garibaldi” nr.33, Prishtinë.

VIII INFORMATA PLOTËSUESE

VIII.1 ANKESAT

Në përputhje me Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, respektivisht Neni 41 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore.

VII.2 ADRESA

Rr. Garibaldi 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000

URL (<i>nëse aplikohet</i>): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni I Prokurimeve	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/451	Fax: 038 243 763